



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 562 Prot.

Tiranë, më datë 18.04.2023

VENDIM
Nr. 168, datë 18.04.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 18.04.2023:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për Projektin “Rikonstruksioni i banesës Përparim Kore”, Brenda Kufirit Zonë e Mbrojtur e Qendrës Historike Gjirokastrë, me aplikues dhe zhvillues Përparim Kore:
 - Të plotësohet projekti me fletë grafike të detajuara;
 - Të përmirësohet paraqitja grafike;
 - Të detajohen prerjet teknike;
 - Të gjitha zërat e preventivit të jenë në përputhje me manualin e restaurimit;
 - Ndërhyrja në pjesën e tarracës të diferencohet nga pjesa tjetër e çatisë;
 - Të risillen prezantimi i plotë në format .ppt dhe projekti në format të editueshëm.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

